

D E K R E T
Nr.894, datë 21.7.1994

PËR DISA SHTESA NË KODIN PENAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 28, pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

D E K R E T O J :

Neni 1

Pas nenit 71-a shtohet neni 71-b me këtë përmbajtje:

Dëmtimi i rrjetit të ujësjellësit

Lidhja pa leje si dhe çdo ndërhyrje tjetër e bërë në rrjetin e ujësjellësit për marrjen e ujit të pijshëm, dënohet me gjobë ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

Dëmtimi apo shkatërrimi me dashje i rrjetit të ujësjellësit, dënohet me gjobë ose me heqje të lirisë gjer në tre vjet.

Neni 2

Paragrafi i dytë i nenit 71 ndryshohet si vijon:

Dëmtimi i linjave të tensionit të lartë, të ulët e atyre telefonike, dënohet: me gjobë ose me heqje të lirisë gjer në tre vjet.

Neni 3

Neni 71-a ndryshohet si vijon:

Administrimi i ujit pa të drejtë, duke kthyer ose ndryshuar vijën e ujit, duke hapur pendat, duke ndërtuar apo mbyllur kanale kulluese apo vaditëse, vija ose vepra të tjera dënohet me gjobë ose heqje të lirisë gjer në dy vjet.

Neni 4

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Sali Berisha